



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 1.4.2021

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 1.4.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në lidhje me pretendimet e kundërankimit datë 22.6.2020, të subjektit të rivlerësimit z. Anton Martini, ndaj ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi afatin e paraqitjes së ankimit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor 15-ditor (datë 10.6.2020) nga njoftimi i vendimit nr. 231/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, së bashku me një kopje të dosjes së hetimit administrativ të rastit konkret, ka ushtruar të drejtën e ankimit, pasi ka vlerësuar se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij.

Njoftimi i vendimit dhe i akteve të hetimit administrativ dhe shqyrtimit të çështjes nga ana e Komisionit është realizuar nga ana e këtij të fundit, nëpërmjet dorëzimit në Institucionin e Komisionerëve Publikë, nga ana e nëpunësit përkatës Komisionit, në datën 28.5.2020, ora 15.20¹, sikundër rezulton në aktin përkatës “Lajmërim marrje”, nënshkruar rregullisht për datën dhe orën nga nëpunësi i lartpërmendur i Komisionit.

¹ Shihni aktet bashkëlidhur (i) “Lajmërim Marrje”, datë 28.5.2020, për shkresën nr.*** prot., datë 24.3.2020, të Komisionit, me lëndë: “Njoftim vendimi nr. 231, datë 29.1.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe mendim pakice për subjektin e rivlerësimit z. Anton Martini” (ii) zarfi i vulosur nga ana e protokollit të Komisionit, dorëzuar me “Lajmërim marrje”, datë 28.5.2020.

Komisioneri Publik thekson se nuk qëndron pretendimi i ngritur, se është refuzuar marrja në dorëzim e shkresës përcjellëse nr.*** prot., datë 24.3.2020 të Komisionit, vendimit nr. 231/2020 dhe akteve përkatëse të këtij vendimi.

Sikundër edhe ky trup gjykues ka konstatuar nga aktet e administruara në dosjen e inventarizuar të përcjellë për gjykim, nëpunësi përkatës i Komisionit ka përcjellë pranë protokollit të Institucionit të Komisionerëve Publikë shkresën përcjellëse nr.*** prot., datë 24.3.2020, të Komisionit, vendimit nr. 231/2020 dhe akteve përkatëse të këtij vendimi, vetëm një herë, në datën 28.5.2020, ashtu sikurse provohet nga akti i lartpërmendur “Lajmërim marrje”, nënshkruar rregullisht nga nëpunësi i Komisionit dhe Specialistja e Protokollit e Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Kjo procedurë njoftimi është realizuar nga ana e Komisionit dhe Institucionit të Komisionerëve Publikë në çdo rast, qoftë edhe me njoftimin e vendimit të Komisionit për pranimin e ankimit të Komisionerit Publik,² për vendimin konkret nr. 231/2020.

Ndërkohë, Komisioni, me shkresën nr.*** datë 24.6.2020, ka dërguar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (Kolegji), Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), kundërankimin e datës 22.6.2020, të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini, ndaj ankimit të Komisionerit Publik.

Kolegji, me shkresën nr. ***, datë 28.12.2020, ka përcjellë pranë IKP-së aktet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, z. Anton Martini, pranë Kolegjit, lidhur me shqyrtimin e ankimit të vendimit nr. 231/2020.³

Nga aktet e përcjella pranë IKP-së, ndër të tjera, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se akti normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”, nuk i adresohet organeve të rivlerësimit kalimtar, duke qenë se gjykimi kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese nuk është një juridiksion gjyqësor⁴ dhe se ankimi i Komisionerit Publik është paraqitur jashtë afatit ligjor 15-ditor.

Komisioneri Publik, në funksion të këtyre pretendimeve të parashtruara në kundërankim, çmon të parashtrorë sa në vijim:

1. Mbi pretendimin e subjektit të rivlerësimit se akti normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”, nuk i adresohet organeve të rivlerësimit kalimtar, në kushtet kur juridiksioni i rivlerësimit që kryejnë organet e rivlerësimit nuk është një juridiksion gjyqësor.

² Shihni aktin bashkëlidhur “Lajmërim marrje”, datë 17.6.2020, për shkresën nr.*** prot., datë 16.6.2020, të Komisionit me lëndë: “Njoftim i vendimit nr.231/1, datë 16.6.2020, “Për pranimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të subjektit të rivlerësimit, z. Anton Martini”.

³ Kërkesë për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, fletë 1-4; Kërkesë e drejtuar KPK-së më datë 15.6.2020, fletë 1-22; Ankimi i datës 22.6.2020, kundër vendimit nr. 231/1, datë 16.6.2020 të KPK-së, fletë 1-25; Prezantim i shkurtër i karrierës ndër vite, fletë 1-7.

⁴ Subjekti i referohet shkresës nr. *** prot., datë 26.5.2020, të Ministrisë së Drejtësisë me lëndë: “Mbi fushëveprimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9/2020...”.

1.1 Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19, Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”⁵, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili, ndër të tjera, solli si efekt shtyrjen e seancave gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale të planifikuara pranë të gjitha gjykatave, si dhe pezullimin e afateve për paraqitjen e ankimeve dhe kryerjen e çdo veprimi procedural.

1.2 Bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 25.3.2020, më datë 25.3.2020, edhe për IKP-në, si palë në procesin gjyqësor, që zhvillohet në Kolegj, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, janë pezulluar të gjitha afatet për paraqitjen e ankimeve, deri më datë 28.5.2020, kur në zbatim të Aktit Normativ nr. 21, datë 27.5.2020, për “Disa ndryshime në Aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020”, ka rifilluar veprimtarinë në kryerjen e funksioneve institucionale.

1.3 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, pretendon se Institucioni i Komisionerëve Publikë, në interpretim të gabuar të Aktit Normativ nr. 9, datë 25.3.2020, ka nxjerrë një njoftim në faqen zyrtare të internetit për pezullimin e afateve për paraqitjen e ankimeve. Gjithashtu pretendon se: [...] *Në kushtet kur juridiksioni i rivlerësimit që kryejnë organet e rivlerësimit nuk është një juridiksion gjyqësor.... , ... çmoj se afatet e ankimit të Komisionerit Publik për t’iu drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese nuk janë pezulluar, pasi nuk hynë në fushën e veprimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 25.3.2020 [...].*

1.4 Komisioneri Publik, lidhur me sa më sipër, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit se juridiksioni i rivlerësimit nuk është një juridiksion gjyqësor dhe nuk hyn në fushën e veprimit të Aktit Normativ nr. 9/2020, sjell në vëmendje qëndrimet e konsoliduara mbi trajtimin e juridiksionit gjyqësor të Kolegjit dhe ushtrimin e funksionit si i tillë.

1.4.1 Në qëndrimin e dhënë nga Komisioni i Venecias, në opinionin e tij të datës 12.12.2016, ku në paragrafin nr. 40, gjithashtu, shprehet: *Për më tepër, sipas nenit 4(6) të ligjit të Vetting-ut (ligji nr. 84/2016), nëse nuk parashikohet ndryshe nga Kushtetuta apo ligji i Vetting-ut, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedura që janë të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Shumë prej rregullimeve procedurale të parashikuara në ligjin e Vetting-ut, që kanë të bëjnë me procedurat para Kolegjit të Apelit, janë hartuar mbi bazën e cilësimit të këtij procesi si një “proces gjyqësor”, duke qenë se ato parashikojnë zbatimin – ose jo – të rregullimeve që kanë të bëjnë me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (shih, për shembull, nenet 62(3), 63(2) dhe 65(1) të ligjit nr. 84/2016).⁶*

1.4.2 Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, datë 9 shkurt 2021, është shprehur se Kolegji i Posaçëm i Apelit plotëson kushtet ligjore dhe Kushtetuese të një “gjykate të vendosur me ligj” dhe funksionon si i tillë⁷.

⁵ Akt Normativ, që ka hyrë në fuqi menjëherë (shihni vendim nr. 24/2006 të Gjykatës Kushtetuese).

⁶ Qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji në Vendimin (JR) nr. 3/2019, prg. 54.

⁷ Referohuni prg. 280-288 të vendimit Xhoxhaj kundër Shqipërisë, datë 9 shkurt 2021 të GJEDNJ-së.

1.4.3 Po ashtu, dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 00–2020-569, datë 12.10.2020 ka vlerësuar se: [...] në nenin “F”, pika 1 e aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet përbërja, funksioni dhe statusi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, konkretisht: “*Kolegji i Apelimit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor...*”, çka nënkupton se Kolegji i Posaçëm i Apelimit është organ gjyqësor dhe ushtron funksionin si i tillë [...].

1.5 Për sa më sipër, veprimtaria institucionale e Kolegjit, në ushtrim të juridiksionit gjyqësor, të njohur nga Kushtetuta dhe ligji, përfshihet në fushën e veprimit të Aktit Normativ nr. 9/2020 dhe hyrja në fuqi e tij ka kufizuar veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë, duke pezulluar, ndër të tjera, dhe të gjitha afatet për paraqitjen e ankimeve.

1.6 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për antikushtetueshmërinë e Aktit Normativ nr. 9/2020, për sa i takon pezullimit të afateve të procedurave gjyqësore, në kushtet e vërtetuara të një pandemie botërore të shkaktuar nga virusi Sars Cov-2, rrethanë kjo e njohur dhe e deklaruar si e tillë nga Organizata e Shëndetësisë e Kombeve të Bashkuara, OBSH), edhe në referencë të institutit të forcës madhore, që legjislacioni kombëtar njeh dhe zbaton, në vlerësimin e Komisionerit Publik nuk qëndrojnë.

2. Mbi pretendimin e subjektit të rivlerësimit për paraqitjen e ankimit të Komisionerit Publik jashtë afatit ligjor

2.1. Komisioneri Publik është organ kushtetues, që vepron në bazë të nenit C, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, i cili përfaqëson interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, brenda afatit 15-ditor nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

2.2. Për shkak të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, Komisioni është një ndër institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, pas zhvillimit të një procedure hetimore të thelluar administrative, në të cilën Komisioneri Publik, nuk është palë procedurale, në asnjë fazë procedurale të zhvillimit të hetimit dhe shqyrtimit të çështjes nga ana e Komisionit.

2.3. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pas marrjes së vendimit nga ky i fundit.

2.4. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik vlerëson nëse vendimmarrja e Komisionit është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, vetëm pasi njihet me vendimin e Komisionit, si dhe kopjen e dosjes me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ.

2.5. Komisioni, në aktin nënligjor të hartuar në zbatim të nenit 69, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Rregullore për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, ka parashikuar në nenin 33, se: *njoftimi i vendimit të trupës gjyqësore bëhet sipas parashikimeve të nenit 55, pika 7, të ligjit nr.*

84/2016 dhe Kryetari i Komisionit i dërgon Komisionerit Publik së bashku me vendimin dhe një kopje të dosjes.

2.6. Në të tilla rrethana kushtetuese dhe ligjore, Komisioni do të konsiderohet se, vetëm më datë 28.5.2020, ka njoftuar pranë Komisionerëve Publikë, vendimin nr. 231, datë 29.1.2020, duke mundësuar kështu ushtrimin e së drejtës kushtetuese të Komisionerit Publik, në drejtim të mbrojtjes së interesit publik dhe procesit të rregullt ligjor.

2.7. Publikimi i vendimit të anonimizuar në faqen zyrtare të Komisionit apo njoftimi i këtij vendimi në një nga dhjetëra adresat elektronike të strukturave të Institucionit të Komisionerëve Publikë, nuk përmbush kriteret ligjore, që duhet të përmbajë njoftimi i vendimit, pasi në çdo rast, nuk mundëson Komisionerin Publik, i cili nuk është palë në procesin e rivlerësimit dhe nuk vlerëson nëse vendimi është i drejtë, nisur vetëm nga përmbajtja e tij, pa u bazuar në unitet me provat e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ.

2.8. Në vijim vlejme të sjellim në vëmendje, se përmbajtja e një pjese të dosjes së Komisionit për subjektin e rivlerësimit, e lidhur me verifikimin e njërën prej kriterëve të rivlerësimit, atë të pastërtisë së figurës, është e mbrojtur nga legjislacioni për sekretin shtetëror. Në rastin konkret, për subjektin e rivlerësimit, organet ndihmëse në procesin e verifikimit të figurës, përveç raportit, sikundër edhe kjo trupë e nderuar ka konstatuar, kanë përcjellë edhe informacione të tjera, të cilat janë të kategorizuara “sekret shtetëror”, për shkak të përmbajtjes së tyre. Legjislacioni përkatës që mbron aktet e klasifikuara “sekret shtetëror”, ndalon publikimin e tyre, qoftë edhe në *website*-in e Komisionit ose transmetimin e tyre në komunikim elektronik.

2.9. Komisioneri Publik çmon të nënvizojë se, në asnjë rast, Komisioni nuk i ka njoftuar vendimet dhe aktet e hetimit administrativ nëpërmjet komunikimit elektronik, qoftë edhe me vendime të tjera të publikuara nga ana e Komisionit në faqen e tij të internetit, gjatë periudhës së pezullimit të afateve të ankimit, në zbatim të Aktit Normativ nr. 9/2020.

2.10. Në çdo rast, Komisioneri Publik, ndryshe nga subjekti i rivlerësimit, i cili sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit, pasi çdo njoftim dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të plotësuar për efekt të këtij procesi, nuk e ka një detyrim të tillë ligjor, për sa kohë nuk është palë procedurale në këtë proces hetimi administrativ të Komisionit dhe, si i tillë, asnjëherë nuk ka dërguar pranë Komisionit komunikime formale në lidhje me adresa elektronike, ku jepet pëlqimi dhe shprehet vullneti për pranimin e njoftimeve për efekte procedurale, në zbatim të ligjit.

2.11. Në këto kushte, Komisioneri Publik, duke mos qenë palë e procesit hetimor dhe e shqyrtimit administrativ të çështjes nga Komisioni, nuk njihet me aktet e provat e administruara dhe me rezultatet e hetimit administrativ, përveçse sipas procedurës dhe formës së parashikuar nga ligji.

2.12. Në përfundim, Komisioneri Publik rezulton se ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 231/2020, të Komisionit, të njoftuar më datë 28.5.2020, brenda afatit ligjor 15-ditor, të parashikuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016⁸.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

⁸ Shihni aktin nr. 203/7 prot., datë 10.6.2020 me lëndë: “Përcillet ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr.231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Anton Martini”.